

K O M E N T

Date 12.02.2020

Pershendetje.

Ne fund te vitit 2019, me ligjin 84/2019 datë 18.12.2019 me hyrje ne fuqi me daten 15.01.2020, eshte bere nje ndryshim ne ligjin 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

Ky ndryshim konsiston ne detyrimin per te plotesuar deklaraten vjetore te te ardhurave te gjithe individet qe janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës të cilët llogarisin tatimin mbi te ardhurat personale.(montimi ligjor ne fund te ketij komenti)

Rreth ketij argumenti do te parashtroje mendimin tim si me poshte:

1.Per vitin 2019 per te cilin deklarata individuale vjetore e te ardhurave do te plotesohet deri me 30 Prill 2020 nuk ka asnje ndryshim.

2.Per vitin 2020 per te cilin deklarata individuale vjetore e te ardhurave do te plotesohet deri me 30 Prill 2021

a) Te gjithe ata individe qe te ardhurat vjetore, ku perfshihen dhe te ardhurat nga 1 (nje) punesim, i kane nen 2.000.000 leke, **nuk kane detyrim** per te plotesuar deklaraten vjetore te te ardhurave.

b) Te gjithe ata individe qe te ardhurat vjetore, ku perfshihen dhe te ardhurat nga 2 (dy) punesimi, i kane nen 2.000.000 leke, **kane detyrim** per te plotesuar deklaraten vjetore te te ardhurave dhe i nenshtrohen tatimit mbi pagat.

c) Te gjithe ata Persona Fizike te Vetepunesuar qe paguajne kontribut per sigurime shoqerore per nje page p.sh. 100.000 leke ne muaj, edhe ne rastin kur eshte i punesuar ne nje shoqeri me nje page p.sh. 30.000 leke ne muaj, **nuk kane detyrim** per te plotesuar deklaraten vjetore te te ardhurave.

d) Te gjithe ata Persona Fizike te Vetepunesuar qe paguajne kontribut per sigurime shoqerore per nje page p.sh. 100.000 leke ne muaj, edhe ne rastin kur eshte i punesuar ne dy shoqeri me nje page p.sh. 30.000 leke ne muaj tek sejcila shoqeri, **kane detyrim** per te plotesuar deklaraten vjetore te te ardhurave.

Per kete kategori per piken c dhe d vete ligji shprehet

Ky përjashtim nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës.

Ne baze te ketij percaktimi kemi:

- **i vetepunesuari per vehten e tij** nuk eshte individ por Person Fizik (Tregetar i Regjistruar TR) dhe si i tille **nuk eshte subjekt i deklarimit** vjetor te te ardhurave.
- **I vetepunesuar kur eshte i punesuar ne nje shoqeri** dhe te ardhurat vjetore (pa te ardhurat e Biznesit te vogel) jane nen 2.000.000 leke **nuk ka detyrim** per te plotesuar deklaraten vjetore te te ardhurave pasi konsiderohet i punesuar ne nje punedhenes.
- **I vetepunesuari kur eshte i punesuar ne dy shoqeri** dhe te ardhurat vjetore (pa te ardhurat e Biznesit te vogel) edhe kur jane nen 2.000.000 leke **ka detyrim** per te plotesuar deklaraten vjetore te te ardhurave pasi konsiderohet i punesuar ne dy punedhenes.

Per sa parashtrova, gjykimi eshte i gjithesejcilit.

Ju faleminderit
Luan Gosnishti
Auditues Ligjor

Ligji. 8438 datë 28.12.1998
“Për Tatimin mbi të Ardhurat”

Neni 13

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave

4. Përfshihen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2.000.000 (dy milionë) lekë.

Ky përjashtim nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit.

(Ndryshuar me ligjin 84/2019 datë 18.12.2019 me hyrje ne fuqi me daten 15.01.2020)